



## **Analizë e ligjit**

**05/2017**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

## Analizë e Raportit Vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil 2016

---

*“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”*

## Raportit Vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2016

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të AAC për vitin raportues 2016. Kjo analizë përkon me preokupimin e vazhdueshëm të INDEP me çështjen e agjencive të pavarura dhe instrumenteve mbikëqyrëse së punës së tyre. Raporti i agjencive të pavarura mbetet instrumenti i vetëm që aktualisht Kuvendi i Republikës e ka për të balancuar pavarësinë me llogaridhënjen, një objektivë që ka qenë në vazhdimësi sfidë ndaj agjencive të pavarura.

Bazuar në ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil të Kosovës, Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës duhet të raportojë në Kuvend të Kosovës me specifikat e mëposhtme:

*15.2 Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Drejtori i Përgjithshëm duhet të përgatisë, përfundojë dhe sigurojë Bordit, Ministrisë, Qeverisë dhe Kuvendit, një raport gjithëpërfshirës vjetor i çili siguron informata të bollësishme për vitin e shkuar kalendarik lidhur me:*

- *organizimin, veprimtarinë, personelin dhe nivelin e rrogave të AAC,*
- *prokurimet, menaxhimin financiar dhe çështjet buxhetore të AAC*
- *të gjitha ankesat administrative, kontestet (konfliktet) dhe procedurat e paraqitura ose të zhvilluara*
- *gjatë vitit të shkuar kalendarik; të gjitha vendimet dhe masat mbi çështjet ekzekutive, rregullore ose të licencimit të AAC.*
- *Ky raport vjetor duhet të përmbajë, në formë të shtojcës, planin e punës dhe atë financiar për vitin e shkuar kalendarik.*

Përveç kërkesave të parapara me ligj për raportim, INDEP e ka parë të nevojshme që AAC të raportojë rreth punës që ka bërë duke u bazuar në masë më të madhe në përgjegjësitë dhe kompetencat siç janë të parapara në Ligjin për Aviacionin Civil të Kosovës. Duke raportuar në detaje rreth plotësimit të përgjegjësisë dhe kompetencave të parapara me ligj, AAC jep një pasqyrë më të qartë rreth punës së bërë gjatë një viti. INDEP e sheh të nevojshme përfshirjen e detajeve, me theks të veçante në specifikat e punës së Bordit dhe menaxhmentit të AAC, dhe përmbushjen e planit të veprimit të paraparë për vitin raportues. Për këtë qëllim, tashmë ka tre vite që është harmonizuar Manuali për raportim të agjencive të pavarura në Kuvendin e Kosovës. Në bazë të këtij manuali, pikat shtesë për të cilat do të duhej të raportonte AAC-ja në bazë të mandatit të saj janë:

*6.1.1. Këshillat dhe propozimet e ofruara nga AAC për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e aviacionit civil.*

*6.1.2. Statistika rreth licencave, certifikatave dhe lejeve të aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre.*

*6.1.3. Informatat e shpërndara për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC-së.*

*6.1.4. Avionët civil të regjistruar dhe ata të larguar nga Regjistri i Avionëve Civil.*

*6.1.5. Inspektimet e kryera në platformë dhe kontrollimet në vend.*

*6.1.6. Bllokimet e Avionëve të Rrezikshëm.*

*6.1.7. Dispozitat ndëshkimore të shqiptuara.*

INDEP ka analizuar në vazhdimësi raportet vjetore të AAC-së, ndërkaq raporti i sivjetmë ka plotësuar pjesërisht kërkesat e Manualit për Raportim të Agjencive të Pavarura, ku mungojnë informata për aktivitetet kyçe që kësaj agjencie i janë vënë si obligime me ligj. Për më tepër, ky raport ndonëse përmbush në shikim të parë pritjet, është substancialisht i mangët sa i përket raportimit për shkak se jo gjithë çka ka ndodhur gjatë 2016 është e përfshirë në raport, çka lë hapësirë për dyshim rreth shkeljes së ligjit.

## Të gjeturat e raportit

INDEP vlerëson që ky raport vetëm sipërfaqësisht i është përmbajtur Manualit për Raportim të Agjencive dhe Institucioneve të Pavarura. Përndryshe, raportit i mungojnë të dhëna specifike dhe të nevojshme për ta treguar punën e bërë gjatë vitit 2016 të AAC-së, e cila do të duhej të fokusohet në përmbushjen e detyrave ligjore të kësaj agjencie. Për më tepër, AAC-ja dështon t'i raportojë dy ndodhi mjaft të rëndësishme për të cilat kanë raportuar mediet gjatë vitit 2016 e që lidhen pikërisht me përmbushjen e një prej detyrave kyçe të AAC-së; çka e cenon rëndë kredibilitetin dhe seriozitetin e këtij raporti. Për më tepër, në këtë raport ka shumë pjesë teksti të kopjuara nga raporti i vitit 2015. Po thuajse të gjitha pjesët e raportit ku prezantohen predispozitat e përgjithshme të AAC-së janë të kopjuara nga raporti paraprak. Kjo lë përshtypjen e mungesës së kreativitetit, por edhe më shumë ngrit pyetjen në ky raport është prezantues i përgjithshëm i AAC-së dhe jo raport vjetor.

Sa i përket organizimit, personelit dhe financave të AAC-së, vëmë re se agjencia e paraqet nevojën e rritjes së personelit nga 27 në 37. Megjithatë i tërë raporti mëton të shfaqë përmbushjen e tërësishme të planit të punës për vitin 2016; AAC-ja duhet të tregojë përse i duhet rritja e personelit nëse numri aktual i stafit është i mjaftueshëm për përmbushjen e rreth 91% të planit të punës së kësaj agjencie. Për më shumë, raporti nuk jep të dhëna specifike për mosrealizimin të tërësishëm të planit të punës, të veprimit dhe aktiviteteve mbikëqyrëse. Arsyetimet e dhëna janë sipërfaqësore. INDEP vlerëson se raporti duhet të përfshijë arsyet specifike për sfidat në përmbushjen e planit të punës që, ndër tjerash, ta shfrytëzojë raportin edhe si apel ndaj institucioneve përgjegjëse qoftë për rritje të personelit, qoftë për rritje të buxhetit etj.. Ndonëse në raport thuhet që buxheti për vitin 2016 ka qenë i shkurtuar, AAC-ja nuk ka dhënë informata se si dhe në çka specifikisht ka ndikuar shkurtimi i buxhetit në funksionimin e tërësishëm të kësaj agjencie dhe në realizimin e mandatit që ka.

AAC ka raportuar që ka miratuar një një skemë nxitëse për të cilën nuk jepen detaje. AAC-ja, në zbatim të përgjegjësisë të veta për rregullimin e tarifave aeronautike në aeroport, ka miratuar në shkurt të vitit 2016 një skemë nxitëse të propozuar nga operatori i ANP-së që konsiderohet të ketë pasur ndikim në hyrjen e operatorëve të ri në treg dhe në shtimin e trafikut gjatë vitit.<sup>1</sup> Sidoqoftë, në pjesën e programeve nxitëse AAC do të duhej të përgjigjej këtyre pyetjeve:

- Cilat kompani ajrore kane përfituar nga këto programe nxitës?
- Sa është vlera monetare e përfitimit për secilën kompani?
- Cilat janë rezultatet në rritjen e numrit të udhëtarëve dhe numrit të fluturimeve për secilin program nxitës?
- Për cilat destinacione të reja është dhënë incentivë?

Një tjetër shqetësim i kahmotshëm që ne e kemi shfaqur në vazhdimësi ka qenë tarifa e sigurisë prej 2 eurove që i vendoset secilit udhëtar që udhëton me fluturime komerciale nga Kosova. “Sipas Ligjit për Aviacionin Civil dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, fondet e mbledhura nga kjo tarifë sigurie janë të ardhura të dedikuara për AAC-në me qëllim të mbulimit të

**Edhe pse mbledhet si taksë e dedikuar për AAC-në, taksë e sigurisë prej 2 eurove mbledhë dyfish më shumë mjete sesa buxheti i tërësishëm i Autoritetit.**

---

<sup>1</sup> Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, (2017), Raporti Vjetor për vitin 2016, faqe 9, Prishtinë: AAC.

shpenzimeve operative.”<sup>2</sup> Megjithatë, buxheti i tërësishëm i AAC-së për vitin 2016 ishte vetëm 925,274 €, ndërkohë që nga taksa e sigurisë ishin mbledhur mbi 3 milion e 400 mijë euro. INDEP ka apeluar vazhdimisht që të ulet kjo tarifë për shkak të parimit të ekuivalentit në përcaktimin e taksave publike.<sup>3</sup> Nëse ato mblidhen për një qëllim të caktuar siç në këtë rast është mbulimi i shpenzimeve operative të AAC-së, atëherë është e qartë që taksa prej 2 eurosh do të duhej të ulej në 0.5 euro ose maksimalisht 1 euro. Lartësia e taksës duhet të varet nga përmbushja e qëllimit për të cilin mblidhet e jo të shfrytëzohet për mbushje të buxhetit.

Raportit i mungojnë lista e operatorëve aktual, licencat dhe lejet e lëshuara në vitin 2016. Edhe pse nuk pajtohem me gjithçka dhe kemi vërejtje e sugjerime për punën e tyre, raportet e ZRRE-së dhe KPMM-së kanë të listuara këso informata të cilat ndikojnë shumë në rritjen e transparencës së raportit në përgjithësi. Në anën tjetër, raporti përfshin të dhëna për emërimin e bordit mbikëqyrës dhe mandatin e tyre, por raporti nuk tregon se çfarë ndikimi ka pasur funksionalizimi i bordit pas dy viteve mungesë. INDEP vlerëson që raporti duhet të japë krahasime të funksionimit të AAC-së të viteve paraprake në mungesë të bordit me vitin 2016 kur ky bord është funksionalizuar.

Për më shumë, raporti vazhdon ta paraqesë vetëm njërën anë të medaljes së funksionimit të AAC-së edhe përgjatë raportimit të auditimit të sistemit të vet, ku thuhet se AAC-ja në baza vjetore duhet të auditohet sistemin e vet, ta masë kënaqshmërinë e atyre që pranojnë shërbime nga ky autoritet, t’i rishikojë realizimin e punësve nëpër tremujorë dhe ta rishikojë menaxhimin e punës në organizatë në përgjithësi. Nga aktivitetet e paraqitura në këtë drejtim, vërejtjet konsistojnë në:

- Nuk jepen të dhëna se kush kanë qenë auditorët e brendshëm; cilat kanë qenë vërejtjet dhe rekomandimet.
- Nuk jepen të dhëna për rreziqet e identifikuar për realizimin e pesë objektivave strategjike të AAC-së. Thuhet të jenë marrë masa parandaluese apo përmirësuese; nuk tregohet çfarë masa.
- Thuhet të jetë matur kënaqshmëria e shfrytëzuesve të shërbimeve të AAC-së përmes një pyetësori të shkurtër; nuk tregohet ç’pyetje ka përmbajtur ai pyetësor, nuk tregohen rekomandimet e dhëna nga këta operatorë për funksionimin e AAC-së. Për më shumë, nuk tregohen as rezultatet e matjes së brendshme së kënaqshmërisë dhe vërejtjet apo rekomandimet e vet personelit të AAC-së.
- Thuhet të jetë mbajtur takimi vjetor i menaxhmentit të AAC-së për rishikimin e menaxhimit gjatë vitit 2016. Nuk ka të dhëna që tregojnë përfundimet e këtij takimi; vërejtjet dhe rekomandimet për menaxhment.

E njëjta qasje vazhdon të përdoret edhe në pasqyrimin e takimeve brenda dhe jashtë shtetit. Në raportimin për bashkëpunimin me Komisionin Parlamentar të ZHEITI, Ministrinë e Infrastrukturës, ZRRE-në, Policinë e Kosovës, raporti mëton të pasqyrojë shumësinë e bashkëpunimeve në të përmendur, por dështon t’i pasqyrojë efektet dhe dobitë e këtyre takimeve. INDEP vlerëson se në vend se ky raport të tregojë për vendmbajtjen dhe datat e takimeve, duke i përmbledhur rezultatet në fjalinë “... u diskutua për çështje të tjera me rëndësi në fushëveprimin e AAC-së.” si në rastin e takimit me Komisionin e ZHEITI, raporti nëse do t’i përfshijë të gjitha takimet veç e veç duhet të tregojë për rezultatet specifike të këtyre takimeve – se si një takim i ka ndihmuar apo si ka shërbyer në avancimin e përgjithshëm të AAC-së – që do t’i arsyetonte përfshirjen kaq specifike të secilit takim. Përfshirja dhe raportimi në këtë mënyrë e takimeve të

---

<sup>2</sup> Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, (2017), Raporti Vjetor për vitin 2016, Të hyrat financiare të AAC-së, faqe 12, Prishtinë: AAC.

<sup>3</sup> Për më tepër shih publikimin e INDEP: “Taksat e dedikuara në Kosovë – çka po marrim në këmbim të pagesës?”, në: <https://goo.gl/GfhGyt> (qasur në prill, 2017).

ndërmarrja, përveçse tregon mungesë përmbajtjeje, i shkakton dëm narrativës së përgjithshme të raportit mbi punën e AAC-së. P.sh në raport është përfshirë reagimi ndaj ndihmës shtetërore që Maqedonia u ka ofruar kompanive ajrore, reagim i cili i është dërguar Komisionit European në korrik nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së. Në anën tjetër, raporti përfshin edhe takimin e Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së me homologët e tij në Shqipëri dhe Maqedoni. Në asnjë rresht të raportimit mbi këtë takim, nuk përmendet të jetë diskutuar lidhur me shqetësimin e AAC-së së Kosovës me ndihmat shtetërore të Maqedonisë ndaj disa kompanive ajrore. Në njëërën anë, ngritet pyetja pse nuk është diskutuar ky shqetësim mes këtyre dy palëve, përderisa është cilësuar si problem mjaft i madh nga pjesa tjetër e raportit. Në anën tjetër, edhe nëse është diskutuar për këtë shqetësim, ngritet pyetja se pse nuk është përfshirë në raport.

Në bazë të ligjit AAC është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroportëve<sup>4</sup>. Kjo përfshinë autoritetin për përcaktimin e tarifave për shërbimet aeronautike. Megjithatë, AAC nuk ka raportuar nëse ka shqyrtuar raportet financiare të ANP “Adem Jashari” dhe nëse ka garantuar që këto tarifa nuk e kalojnë koston e ofrimit të shërbimeve. Për këtë, AAC ka pushuar së raportuari që kur është bërë koncesionimi i aeroportit. AAC nuk ka bërë rregullimin ekonomik që do të garantonte se tarifat nuk kalojnë koston e ofrimit të shërbimeve. Gjithashtu, nuk tregohet sa kanë qenë të hyrat e aeroportit nga këto tarifa dhe cili është destinimi i tyre.

Autoriteti për Aviacionin Civil, ndër tjerash, e ka obligim ligjor ta bëjë rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës. Në raport thuhet se “Me qëllim të ngritjes së sigurisë në aviacion duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja menaxhon sistemin e raportimit të ndodhive në aviacionin civil, përmes së cilit mbledh informacione relevante për sigurinë e aviacionit civil, bën procesimin e tyre, hetimin, analizimin, ruajtjen, shkëmbimin dhe shpërndarjen e tyre, duke përfshirë atribimin e fajit apo përgjegjësisë.”. Ndonëse raporti jep të dhëna sipërfaqësore mbi ndodhitë në aviacion gjatë vitit 2016 – ku përfshihet, ndër tjerash, futja e qenve dhe shpendëve në ANP – AAC duket se ka harruar të përmend dy ndodhi mjaft të rëndësishme gjatë vitit 2016, për të cilat të gjitha mediet në Kosovë kishin raportuar:

- **Dënimi i kryeshefit ekzekutiv të Aeroportit “Adem Jashari” me 5 mijë euro nga Departamenti i Aviacionit Civil në Ministrinë e Infrastrukturës.**<sup>5</sup>
- **Mosfunksionimi i sistemit të radarit në Golesh për tri ditë.**<sup>6</sup>

**Çka është akoma më shqetësuese është se as raporti vjetor i vitit paraprak nuk e përmend ndodhinë e aterimit pa leje të aeroplanit të Bexhet Pacollit në ANP me 26 tetor 2015<sup>7</sup>, ani pse këto janë konfirmuar nga vetë zyrtarë të ANP-së. Këto dy ndodhi dhe mospërfshirja e tyre nga AAC-ja në raportet vjetore përkatëse, përbëjnë shkelje nga AAC-ja dhe duhet të adresohen. AAC-ja do të duhej t’i përfshinte këto të dyja në raportet vjetore përkatëse duke treguar për më shumë se çfarë masa ndëshkimore ka ndërmarrë AAC-ja për këtë rast, si ka ndikuar ky rast në kredibilitetin e ANP-së dhe se cilat janë rreziqet potenciale të ndodhive të tilla. Mos raportimi i kësaj ndodhie dhe përmendja e bashkëpunimit të ofruar për aksidentin e kompanisë ajrore “Turkish Airlines”,**

<sup>4</sup> Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil në Republikën e Kosovës, faqe 13, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2532> (qasur në prill, 2017).

<sup>5</sup> Gazeta KNN (2016), Sherri i Behgjet Pacollit dënohet me 5 mijë euro Kryeshefi i Aeroportit të Prishtinës, e qasshme në <http://aab-edu.net/media/gazetaknn/arkiva/news/41230/18/Sherri-i-Behgjet-Pacollit-denohet-me-5-mije-euro-Kryeshefi-i-Aeroportit-te-Prishtines> (qasur në prill, 2017)

<sup>6</sup> Gazeta Koha (2016), Agjencia Ajrore pranon problemin me radarin, thotë se nuk u cenua siguria e operimeve e qasshme në: <http://archive.koha.net/?id=27&l=149731> (qasur në prill, 2017).

<sup>7</sup> Gazeta Lajmi.net (2016), Behgjet Pacolli shkaktoi kaos ajror, ateroi pa leje në Aeroportin e Prishtinës e qasshme në: <http://lajmi.net/behgjet-pacolli-shkaktoi-kaos-ajror-ateroi-pa-leje-ne-aeroportin-e-prishtines/> (qasur në prill, 2017).

dhe operimin ilegal të dronëve; lë hapësirë për të dyshuar nëse AAC-ja me anë të raportimit të incidenteve të vogla, po tenton të kamuflojë mungesën e raportimit të incidenteve më të mëdha dhe më të rrezikshme.

Në anën tjetër, raporti vjetor i AAC-së nuk tregon për mosfunksionimin e sistemit të radarit në Golesh për tri ditë. Mosfunksionimi i kontrollorëve të trafikut ajror nënkuptonte se këta kontrollorë nuk kanë pasur fotografi të aeroplanëve në hapësirën ajrore të Kosovës për tri ditë. Për më shumë, në dokumentin e siguruar nga Koha.net, thuhet se dokumenti i është dërguar autoritetit të aviacionit civil dhe departamentit për siguri në kontrollin ajror. Por, AAC-ja duket se nuk e konsideruar të rëndësishme përfshirjen e kësaj ndodhie në raportin vjetor. AAC-ja përveçse do të duhej ta përfshinte këtë në raportin vjetor, do të duhej edhe të tregonte se cilat kanë qenë pasojat e mosfunksionimit të këtij sistemi në sigurinë e përgjithshme të transportit ajror, çka ka ndërmarrë AAC-ja me rastin e kësaj ndodhie, a janë gjetur shkaqet dhe cilat masa janë ndërmarrë për preventimin e ndodhive të tilla në të ardhmen. Këto dy raste të paraportuara në raportin vjetor të AAC-së ngrisin dyshime për mundësinë e ekzistimit të më shumë rasteve të tjera të paraportuara dhe e vënë në pikëpyetje të madhe vetë kredibilitetin dhe seriozitetin e AAC-së. Për më shumë, duke qenë se rregullimi i sigurisë është një ndër detyrat kyçe të kësaj agjencie, AAC-ja i ka dhënë fare pak hapësirë në raport aktivitetëve të ndërmarrë në këtë drejtim ku ndodhive në aviacion i ka dhënë vetëm gjysmë faqe, ndërkaq takimeve dhe përfaqësimeve në vend e jashtë vendit i ka dhënë më shumë se 10 faqe.

**Nuk është raportuar asnjë informatë për mosfunksionimin e sistemit të radadit në Golesh për tri ditë.**

Në të njëjtën linjë, gjatë raportimin mbi mbikëqyrjen e ASHNA-s thuhet se një vizitë inspektuese në janar 2016, përveç tjerash është ndërmarrë për shkak të “... **disa ndodhi të raportuara gjatë muajit dhjetor, të cilat ishin duke u hetuar nga ana e AAC-së**”, ndërkaq gjatë auditimit në muajin qershor në ASHNA, thuhet të mos jetë hapur ndonjë gjetje e re, por se “... **u mbyll një gjetje nga auditimet e kaluara.**”. AAC duhet ta ketë parasysh se raporti vjetor nuk shërben për të qenë vetëm pasqyrë e arritjeve e as si promovues i “mirëfunksionimit” të kësaj agjencie. Raporti vjetor duhet të përmbajë se cilat kanë qenë ndodhitë brenda ASHNA-s që AAC-ja ka qenë duke hetuar dhe se cila gjetje është mbyllur. Mos raportimi i dy ndodhive të lartpërmendura, si dhe përmendja kalimthi i hetimeve që AAC-ja ka qenë duke i kryer në ASHNA, tregojnë që ky raport nuk është i drejtuar nga pasqyrimi real i gjendjes dhe mbarëvajtjes së kësaj agjencie; por se i është vënë më shumë detyra e të qenit një përmbledhje promovuese e kësaj agjencie.

Në anën tjetër, Manuali kërkon që AAC-ja të ofrojë statistika rreth licencave, certifikatave dhe lejeve të aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre. Nga ajo që shohim në raportin vjetor të AAC-së, është një mangësi e dukshme në raportimin e kësaj natyre. Përveç licencave të lëshuara nga sektori i mjekësisë së aviacionit dhe lejet për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit; ku jipen të dhëna lidhur me atë se kujt i janë lëshuar licencat; në llojet e tjera të lëshuara të licensave, nuk jipen të dhëna për të licencuarit (përveç numrit të licencave të lëshuara), as sa prej kërkesave për licencim janë refuzuar si dhe arsyet për refuzimet potenciale. Në të njëjtën linjë, nuk ka ndonjë të dhënë për pezullimet dhe revokimet potenciale të licencave. Ngjashëm mungojnë të dhëna për licencimin e kontrollorëve të trafikut ajror (KTA), ku jepet vetëm numri i të licencuarve dhe asnjë e dhënë më shumë. INDEP vlerëson se AAC-ja, për hir të transparencës së i obligohet duke qenë i financuar nga taksapaguesit, duhet të japë të dhëna të hollësishme për licencat që i lëshon dhe ato që i refuzon.

## Përfundime dhe rekomandime

- Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2016 nuk është i plotë në informata dhe një pjesë e konsiderueshme e të dhënave të rëndësishme janë shmangur nga raportimi. Informata si numri i operatorëve, lista e tyre, lista e licencave dhe lejeve të lëshuara etj, mungojnë nga ky raport.
- Raporti edhe njëherë shpërfaqë shqetësimin e INDEP në lidhje me mënyrën se si qytetarët po paguajnë taksa të dedikuara për një qëllim të caktuar edhe pse niveli i tyre tejkalon shumëfish qëllimin për të cilin mblidhen. Qytetarët për vite me radhë po paguajnë taksën e sigurisë prej 2 eurosh për secilin udhëtar si taksë e dedikuar për mbulimin e shpenzimeve operacionale të AAC-së. Në bazë të shifrave të tanishme, del që nga kjo shumë që mblidhet në emër të shpenzimeve operacionale vetëm rreth  $\frac{1}{4}$  e saj dedikohet për AAC-në.
- AAC duhet të japë shpjegime pse nuk janë përfshirë në raport dy ndodhitë e lartpërmendura; dënimi i drejtorit të ASHINA-s dhe mosfunksionimi i radarëve për 3 ditë. Dhe për më shumë, duhet të japë të dhëna specifike për çështjet për të cilat është duke hetuar dhe jo vetëm t'i përmend. Përndryshe, ky raport rrezikon ta humbasë kredibilitetin dhe seriozitetin e një raporti që i dërgohet Kuvendit. Për shkak të lëshimeve të tilla, krijohet hapësira edhe për dyshim nëse gjithçka e raportuar është e saktë dhe nëse ka edhe gjëra të tjera që do të duheshin raportuar.
- Nuk ka të dhëna specifike për licencat e lëshuara apo revokimet a pezullimet potenciale të licencave. Raporti ka përmendur programin mbështetës por nuk ka sqaruar se si kanë ndikuar këto masa në performancën e përgjithshme kur dihet se megjithatë numri i udhëtarëve është më i vogël sesa në vitin 2012. Më tutje nuk është sqaruar se cilat kompani ajrore kanë përfituar nga këto skema mbështetëse, sa është vlera e përfitimeve dhe për cilat destinacione të reja është dhënë incentivë.
- Nuk ka të dhëna mbi vërejtjet dhe rekomandimet që janë marrë nga auditimi i kësaj agjencie. Shpjegohet që për shembull nga ZAP janë dhënë 2 rekomandime kurse nga auditimi i brendshëm nga Ministria e Financave janë dhënë 3 rekomandime por të njëjtat nuk përfshihen në një tabelë dhe nuk shpjegohet më tutje cilat janë masat që janë marrë për adresimin e tyre.

Për shkak të këtyre mangësive, të cilat janë shtjelluar më gjerë në pjesën e parë të analizës, INDEP rekomandon që ky raport të kthehet edhe njëherë në rishqyrtim dhe ripërpunim duke e kuptuar seriozisht nevojën e raportimit gjithëpërfshirës dhe të saktë. Përndryshe, vlera e raporteve vjetore mbetet vetëm formalitet i panevojshëm.



---

*“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.*